



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 05842 prot.

Tiranë, më 15.10.2019

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi

Për publikim: Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe VKM-së 921 datë 29.12.2014, i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

Doganier, Kategoria C2, Kategoria e pagës IV-a, pranë Operatorëve Ekonomikë 3 (tre) vende

- Royal Trade Company
- Europetrol Durrës Sha
- Kastrati Sha

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë shtetësi shqiptare;
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre;
4. Të mos kenë qenë të dënuar për krime dhe që nuk gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
5. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze;
6. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” të arsimit të lartë në shkencat ekonomike, juridike, natyrore, politeknike, të lidhura me sigurinë dhe hetimin, Akademi Ushtarake/Policore.
7. Të kenë njohuri në përdorimin e kompjuterit.

Avantazhe:

1. Njohja e një gjuhe të huaj.

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

- ✓ Në operacionet doganore të Import/Eksportit, merr në dorëzim deklaratën doganore të printuar dhe të firmosur nga administratori apo agjenti doganor shoqëruar me dokumentacionin sipas listës së printuar.
- ✓ Kontrollon në sistem kriteret e përzgjedhjes dhe ndërmerr hapat konkretë për përmbushjen e këtyre kriterëve.
- ✓ Kontrollon gjithë dokumentacionin që shoqëron mallin duke e krahasuar atë me listën e dokumentave bashkangjitur praktikës doganore.
- ✓ Kontrollon dhe verifikon përpuethshmërinë e deklaramit me dokumentacionin shoqëruës.
- ✓ Kontrollon zbatimin e klasifikimit tarifor, origjinës së mallrave.
- ✓ Kryen shënimet përkatëse në sistem në lidhje me aktin e kontrollit dhe procedurën e ndjekur.
- ✓ Propozon për rikanalizim e deklaratës për kontroll fizik tek shefi i zyrës së operacioneve doganore kur ka dyshime në deklaramin e kryer nga subjekti.
- ✓ Në të gjitha rastet, kryen verifikime me prezencë fizike për çdo mjet (autobot) që ngarkohet apo shkarkohet në rafineri, në pikën e lëvrimit të produktit përkatës si dhe gjatë peshimit të tyre.
- ✓ Bashkëpunon me struktura të tjera të DPD dhe më gjerë në lidhje me kërkesat për hyrjen dhe daljen e produkteve të akcizës në dhe nga rafineria.
- ✓ Për çdo automjet që hyn apo del në dhe nga Rafineria, doganieri kryen regjistrimin në regjistrin përkatës të hyrjes apo të daljes.
- ✓ Evidenton sasinë e lëndës djegëse të përdorur në procesin e prodhimit, dhe këto të dhëna janë pjesë e raportit ditor të çdo turni shërbimi doganor.
- ✓ Zbaton me korrektësi procedurat dhe manualet në fuqi për mbikqyrjen dhe kontrollin e Rafinerisë.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim;
2. Curriculum Vitae (dhe letër motivimi);
3. Diplomë dhe Listë Notash të noterizuar;
4. Dëshmi Penaliteti (do të vihet në dispozicion nga DMBNJ);
5. Vërtetim nga Gjykata;
6. Vërtetim nga Prokuroria;
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat (nga portali e-albania);

8. Raport mjeko-ligjor;
9. Kartë identiteti;
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Fotokopje të kurseve kualifikuese;
12. Letër referencë dhënë nga punëdhënësi/eprori direkt i pozicionit të fundit.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e përzgjedhjes bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes personale dhe me intervistë. Kandidatët që marrin mbi 50 pikë në vlerësimin e dosjes konsiderohen të kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në vlerësimin e përvojës, në kualifikimin dhe aftësitë e kandidatit.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 24 . 10 .2019, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Arlind Gjokuta

